

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN REMAS, LUSHNJE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Remas, Lushnje**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 21, datë 23.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1078/10, datë 27.3.2014, i ka rekomanduar z. Agim Rredhi Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit dhe kontrollit të brendshëm, si dhe metodologjia për zbatimin e tij, të hartohet dhe të miratohet Kodi Etik, të identifikohet dhe të krijohet regjistri i riskut, të implementohen procedurat antikorrupsion etj, në zbatim të nenit 8, 10, 12, 20 etj, të ligjit 10,296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Maj 2014

3. Zyra e tatim taksave, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e shumës 3,837,968 lekë nga 33 subjekte debitorë për tatimet dhe taksat lokale të pa paguara për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Mars 2014

4. Komuna Remas të marrë masat e nevojshme për krijimin e të ardhurave nga toka bujqësore e pa ndarë, pyjet, kullotat dhe sipërfaqet ujore, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 *“Për tokat bujqësore të pa ndara”* dhe VKM nr. 135, datë 8.3.2006 *“Për procedurat dhe çmimin e dhënies me qira të sipërfaqes ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”*..

Qershor 2014

5. Të merren masat e nevojshme për përcaktimin e rregullave, për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Qershor 2014

6. Zyra e AMT të komunës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e aseteve në ZVRPP, të cilat me VKM nr. 452, datë 22.5.2013 transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Remas, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *“Për pronat e paluajtshme të shtetit”* i ndryshuar, neni 8 dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”*.

Qershor 2014

7. Të merren masat e nevojshme për marrjen me akt dorëzimi dhe me komision, pronat që me VKM nr. 452, datë 22.5.2013 i kanë kaluar në pronësi të komunës, përfshirë edhe ato të regjistruara në ZVRPP në pronësi të komunës, duke saktësuar gjendjen juridike të tyre në teren, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”* etj.

Qershor 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **14,833,344 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Z. N.Ç., F.K. dhe A.B. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave vlerën **3,716,316 lekë**, nga të cilat 3,241,410 lekë për tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re-Adriatik” i zhvilluar në vitin 2011 dhe 474,906 lekë për tenderin me objekt “Ambulancë TIP A 1”, pasi kanë skualifikuar padrejtësisht OE me ofertë më të ulët dhe kanë kualifikuar padrejtësisht OE me vlerë më të lartë, duke i shkaktuar dëm ekonomik komunës.

Skualifikimet/kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me kriteret e veçanta të kualifikimit të tenderëve, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

2. Z. B.K. vlerën **7,151,760 lekë**, e cila përfaqëson rritjen e çmimeve për dy zëra të punimeve në preventivin e hartuar prej tij për tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Adriatik”, në kundërshtim me VKM nr. 1027, datë 15.12.2010, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e komunës.

3. BOE “S...” sh.p.k. & “H...” sh.p.k. vlerën **2,781,528 lekë**, e cila përfaqëson punime të pakryera, tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Karavasta e Re – Qendër Remas, faza e parë”.

4. Operatorit ekonomik “G...G” sh.p.k vlerën **1,179,540 lekë**, e cila përfaqëson pagesë nga AK, për punime të pakryera në objektin “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Adriatik”.

Pagesat e kryera sipas përshkrimit të bërë në pikën 3 dhe 4 më sipër, janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e komunës.

5. Z. H.RR. punonjës i komunës vlerën **4,200 lekë**, e cila përfaqëson pagesë për punë jashtë kohës normale në kundërshtim me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e komunës.

C. MASA ADMINISTRATIVE.

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, komuna t’i kërkojë Këshillit të Qarkut Fier, si përfaqësues i saj për aktivitetin e INUV, që në bazë të aktmarrëveshjes përkatëse, të vendosë gjobë për mbikëqyrësen e punimeve të ndërtimit, zj. **N.M.** në masën 300,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në procedurën e zbatimit të tenderit me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës Gur-Karavasta e Re-Qendër Remas, faza e I-rë”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik Komunës Remas në vlerën 2,781,504 lekë, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës” i ndryshuar dhe nenin 9 të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 germa “I” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit si më poshtë:

“Ndërprerjen e mardhënieve të punës”

1. Z. N.Ç., me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, pasi:

- Ka skualifikuar padrejtësisht OE me ofertë më të ulët dhe kanë kualifikuar padrejtësisht OE me vlerë më të lartë, duke i shkaktuar dëm ekonomik komunës në shumën 3,726,316 lekë, nga e cila në tenderin me objekt:

- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Adriatik” 3,241,410 lekë,
- “Ambulancë Tip A 1” në fshatin Adriatik, 474,906 lekë, kurse në tenderët me objekt:
- “Sistemim asfaltim i rrugës Sabri Hela - Sravec”,
- “Blerje automjeti”,
- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Qendër Remas”, janë konstatuar parregullsi në procedurën e zhvillimit të tenderëve, por pa dëm ekonomik.

Skualifikimet/kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me kërkesat specifike të tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Nuk ka iniciuar miratimin në këshillin e komunës të tregueseve faktikë të buxhetit për vitet 2011 dhe 2012, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, neni 32 dhe 65.

- Nuk ka parashikuar nga transfertat e pa kushtëzuar, shpenzime për mbështetjen e pemëtarisë dhe gjelbërimit në buxhetin e vitit 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimeve përkatës të Ministrisë së Financave.

- Nuk ka krijuar regjistrat e aktiveve të qëndrueshme me të dhënat e nevojshme, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, “Regjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik”.

2. Z. A.B. me detyrë përgjegjës i ZAMT, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, pasi:

- Ka skualifikuar padrejtësisht OE me ofertë më të ulët dhe kanë kualifikuar padrejtësisht OE me vlerë më të lartë, duke i shkaktuar dëm ekonomik komunës në shumën 3,726,316 lekë, nga e cila në tenderin me objekt:

- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Adriatik” 3,241,410 lekë,
- “Ambulancë Tip A 1” në fshatin Adriatik, 474,906 lekë, kurse në tenderët me objekt:
- “Sistemim asfaltim i rrugës Sabri Hela - Sravec”,
- “Blerje automjeti”,
- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re-Qendër Remas”, janë konstatuar parregullsi në procedurën e zhvillimit të tenderëve, por pa dëm ekonomik.

Skualifikimet/kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me kërkesat specifike të tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- Ka iniciuar propozimin në Këshillin e Ministrave për kalimin në pronësi të pronës me numër pasurie 310, duke i ndryshuar emërtimin në libri i ngastrave nga tokë “arë” në “tokë inproduktive”, pa miratim të Këshillit të komunës dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimi dhe të mbrojtjes së tokës në qarkun dhe zyrat e Menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokë në komunën dhe ose bashki” paragrafi III, pika 5.

- Nuk ka marrë në dorëzim me procesverbal pronat që i kanë kaluar në pronësi komunës me vendim të Këshillit të Ministrave, nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Qarkut Fier etj, të shoqëruara me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen gjendja reale e tyre etj, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM

nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” etj.

- Nuk ka vepruar dhënien me qira të sipërfaqes tokë bujqësore e pa ndarë , në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pa ndara”, neni 5, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pa ndara”, i ndryshuar etj.

- Nuk ka vepruar për dhënien me qira të sipërfaqes pyjore dhe sipërfaqeve ujore të regjistruara në pronësi të komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, kreu IV, neni 19 etj.

3. Z. F.K. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, pasi:

- Ka skualifikuar padrejtësisht OE me ofertë më të ulët dhe kanë kualifikuar padrejtësisht OE me vlerë më të lartë, duke i shkaktuar dëm ekonomik komunës në shumën 3,726,316 lekë, nga e cila në tenderin me objekt:

- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re-Adriatik” 3,241,410 lekë,

- “Ambulancë Tip A 1” në fshatin Adriatik, 474,906 lekë, kurse në tenderët me objekt:

- “Sistemim asfaltim i rrugës Sabri Hela - Sravec” ,

- “Blerje automjeti” ,

- “Sistemim asfaltim i rrugës Karavasta e Re – Qendër Remas”, janë konstatuar parregullsi në procedurën e zhvillimit të tenderëve, por pa dëm ekonomik.

Skualifikimet/kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me kërkesat specifike të tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- Nuk ka ndjekur procedurat ligjore për vjeljen e detyrimeve debitorë të subjekteve taksa pages, për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve me ZVRPP Lushnjë, dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

- Nuk ka krijuar regjistrin e detyrimeve pasive për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet në vite, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, 28, 30 etj.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 1078/12, datë 11.4.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë:

1. Z. A.RR. me detyrë kryetar, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor

2. Z. Z. N.Ç.me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës, në cilësinë e anëtarë të KVO me detyrë kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Z. F.K. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të KVO.

4. Z. A.B. me detyrë përgjegjës i ZAMT, në cilësinë e anëtarit të KVO.

5. Z. B.K. me profesion inxhinier, në cilësinë hartuesit të preventivit.

Nga Komuna Remas Lushnjë, me shkresë protokolluar në KLSH me nr. 1078/13 datë 18.4.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar po pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Fatmir Zilja dhe Josif Lile, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Eral Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT